**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria-Vlada-Government*
**Ministria e Ekonomisë**
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**

# RAPORTI I PROGRESIT PËR VITIN 2024

# I

# PROGRAMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ENERGJISË SË KOSOVËS (PZSEK) PËR PERIUDHËN 2022-2025

**Prishtinë, prill 2025**

# Përmbajtja

1 Shkurtesat: .......... 3
2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .......... 4
3 PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE .. 7
4 PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT .......... 7
5 RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE .......... 9
6 SHTOJCA- MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2024 .......... 12

# 1 Shkurtesat:

| | |
|---|---|
| BE | Bashkimi Evropian |
| BRE | Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë |
| BRE-E | Energjia elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme |
| CERT | Ekipi i komunitetit për reagim urgjent |
| $CO_2$ | Dioksidi i Karbonit |
| EE | Efiçienca e Energjisë |
| ESCO | Kompania e Shërbimit të Energjisë |
| VNMS | Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social |
| PZSE | Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë |
| FKEE | Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë |
| GS | Gazrat Serrë |
| IPF9 | Objekti i Projektit të Infrastrukturës - Asistencë Teknike 9 |
| KEDS | Kompania Kosovare e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| KfW | Instituti i Kredive për Rindërtim |
| KOSTT | Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës |
| Ktoe | Kilo ton ekuivalent naftë |
| MAShT | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit |
| MCAK | Llogaria e Sfidës së Mijëvjeçarit-Kosovë |
| MCC | Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit |
| ME | Ministria e Ekonomisë |
| MFK | Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë |
| MFPT | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| MMPHI | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| MW | Mega Vat |
| MWt | Mega Vat termik |
| NOx | Oksidet e Azotit |
| NQ | Ngrohja Qendrore |
| OSSh | Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes |
| OST | Operatorët e Sistemit të Transmetimit |
| SAIDI | Indeksi Mesatar i Kohëzgjatjes së Ndërprerjes së Sistemit |
| SAIFI | Indeksi i Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve të Sistemit |
| SCADA | Kontrolli Mbikëqyrës dhe Marrja e të Dhënave |
| $SO_2$ | Dioksidi i Sulfurit |
| ETS BE | Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të Bashkimit Evropian |
| WBIF | Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor |
| ZRrE | Zyra e Rregullatorit për Energji |

# 2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ministria e Ekonomisë (ME), ka hartuar Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK), për periudhën 2022-2025, i cili është miratuar më 5 shtator të vitit 2023 në Qeverinë e Republikës së Kosovës (QRK).

Bazuar në nenin 7, pika 7 e Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, Ministria e Ekonomisë (ME), ka obligim ligjor që të bëjë monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës . Prandaj ministria ka hartuar raportin vjetor për vitin 2024, mbi progresin e realizimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025, si dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2022-2031, i cili është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ (UA) të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit (PV).

Raporti i Progresit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për vitin 2024 është hartuar, bazuar në realizimin e aktiviteteve të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025 dhe janë paraqitur aktivitetet e detajuara për zbatimin e objektivave të parashikuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031.

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025, përfshin një listë prej pesë (5) objektivash strategjike, gjashtëmbëdhjetë (16) objektivash specifike dhe nëntëdhjetë e një (91) aktiviteteve që parashihen të realizohen për zhvillimin e sektorit të energjisë.

Raporti i progresit ka për qëllim që të evidentoj shkallën e realizimit të projekteve/aktiviteteve të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për vitin 2024, si dhe të evidentohen sfidat dhe të propozohen rekomandimet për vendimmarrje nga autoritetet përkatëse.

Në raport të progresit janë përfshirë të gjitha projektet dhe aktivitetet që kanë filluar para apo gjatë vitit 2024 dhe që vazhdojnë edhe gjatë viteve të ardhshme, po ashtu edhe projektet dhe aktivitetet të cilat fillojnë dhe përfundojnë në vitin 2024.

Objektivat strategjike janë:

Objektivi 1: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit;
Objektivi 2: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme;
Objektivi 3: Rritja e Efiçiencës së Energjisë (EE);
Objektivi 4: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut;
Objektivi 5: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve.

**Në vitin 2024 si arritje mund të vlerësohen:**

Investimet në rrjetin e transmetimit në nivelet e tensionit të ulët 0.4kV, tensionit të mesëm 35/10(20) kV, nyjet e reja 110/10 (20) kV (OST & OSSh) dhe investimet në rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet të cilave është arritur përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe reduktimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Pastaj investimet në rrjetin e zgjuar (Smart Grid), instalimi i njehsorëve, në Teknologji Informative (TI), nëpërmjet të cilëve është ngritur saktësia në matje, matja në distancë, faturimi dhe leximi i saktë dhe i shpejtë dhe gjithashtu do të rritet edhe siguria dhe mbrojtja e të dhënave, modernizimi i infrastrukturës. Të gjitha këto investime ndikojnë në rritjen e besueshmërisë së sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës.

Arritje tjetër është edhe zbatimi i masave të, Efiçencës së Energjisë (EE) në ndërtesa publike (në nivel qendror dhe komunal) nëpërmjet të cilave është arritur kursim i energjisë në vlerë 6.6 ktoe /vit.

Në fushën e bashkëpunimit rajonal në vitin 2024 janë shënuar këto arritje: Operacionalizimi i tregut një (1) ditë para dhe brenda ditës në kuadër të ALPEX dhe organizimi i ankandit të parë që lidhet me Tregun Brenda Ditor.

Për mbështetjen e konsumatorëve në nevojë dhe konsumatorëve të tjerë, është realizuar subvencionimi i familjeve të cenueshme, dhe subvencionimi i faturave të energjisë elektrike, dhe gjithashtu është aprovuar programi për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm.

Edhe në vitin 2024 ka pasur progres në realizimin e aktiviteteve në sektorin e Ngrohjes Qendrore (NQ), ku kanë vazhduar investimet në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të Ngrohjes Qendrore (NQ) në Prishtinë dhe instalimi i pajisjeve matëse për konsumatorët e “Termokosit” me ç’rast është arritur përmirësimi i sistemit të Ngrohjes Qendrore (NQ) në Prishtinë. Gjithashtu është kryer edhe Studimi i fizibilitetit për rritjen e kapacitetit termik në Kogjenerimin TC “ Kosova B” nga 140 MWth në 280 MWth.

Si arritje tjetër për vitin 2024 është: aprovimi i Ligjit për Promovimin e Përdorimit të BRE-ve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i publikuar në Gazetën Zyrtare (GZ), më datën 02.05.2024 Organizimi i ankandeve konkurruese për të rritur pjesëmarrjen e BRE-ve duke filluar me 100 MW fotovoltaik ku më datë 31.05.2024 është nënshkruar marrëveshja për zhvillimin e projektit dhe marrëveshjet tjera në bazë të dosjes së tenderit, dhe duke vazhduar me hapjen e ankandit të parë për ndërtimin e kapaciteteve të energjisë së erës prej 100 MW në muajin dhjetor të vitit 2024.

Sa i përket standardeve dhe kurrikulave të reja profesionale sipas kërkesave të tregut të punës, janë hartuar katër (4) standarde të reja për fushën e energjisë bazuar në kërkesa të tregut të punës.

Arritja e realizimit të objektivave për vitin 2024 ka qenë pesëdhjetë e shtatë përqind (57%).

Në vazhdim janë paraqitur të arriturat e objektivave në formë tabelore dhe grafike për vitin 2024

| | 2024 |
|---|---|
| Objektivi 1 | 45% |
| Objektivi 2 | 42% |
| Objektivi 3 | 59% |
| Objektivi 4 | 47% |
| Objektivi 5 | 91% |
| **Totali i zbatimit të objektivave** | **57%** |



# 3 PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Në këtë raport të progresit është paraqitur shkalla e zbatimit të aktiviteteve, dhe projekteve të parapara për vitin 2024.

Për përgatitjen e këtij raporti, është themeluar Grupi Koordinues (GK) ndërinstitucional, ku ME-ja, ka përgatitur matricën, dhe ju është dërguar të gjithë anëtarëve të grupit që të raportojnë për të arriturat, sfidat dhe problematikat në zbatimin e projekteve të parapara për vitin 2024. Pas marrjes së inputeve nga anëtarët e Grupit Koordinues (GK), është bërë edhe më tutje përpunimi i matricës dhe është bërë finalizimi.

Bazuar në të dhënat e plotësuara nga institucionet përgjegjëse në matricën e dërguar është përgatitur pjesa narrative e këtij raporti.

Në pjesën narrative është bërë përshkrimi i progresit të secilit objektiv strategjik, ku përshkruhen të arriturat, arsyeja e vonesave të disa aktiviteteve/projekteve, si dhe sfidat për disa projekte të cilat nuk janë realizuar në tërësi.

Përshkrimi i mëposhtëm është bazuar në strukturën e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovë (PZSEK) për periudhën 2022-2025, ku janë të përfshira aktivitetet dhe projektet e vitit 2024.

# 4 PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT

**<u>Objektivi 1: Përmirësimi i Besueshmërisë së Sistemit</u>**

Objektivi "Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit", përfshin të gjitha aktivitetet që garantojnë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe funksionimin e një sistemi elektroenergjetik stabil.

Aktivitetet e parapara, dhe të cilat kanë pasur zhvillime në këtë periudhë, kanë ndikuar në përmirësimin e besueshmërisë së sistemit, kjo është arritur bazuar në këto aktivitete:

- Ndërtimi i nënstacioneve në Ferizaj dhe në Fushë-Kosovë;
- Investimet kapitale në Teknologjinë Informative (TI);
- Projektet e tensionit të mesëm 35/10(20) kV;
- Instalimi i njehsorëve;
- Rrjeti i zgjeruar (Smart Grid).

**<u>Objektivi 2: Dekarbonizimi dhe Promovimi i Energjisë së Ripërtëritshme</u>**

Rruga drejt zvogëlimit të emetimeve të dioksidit të karbonit ($CO_2$) është një element kyç në strategjitë për të arritur qëllimet e qëndrueshmërisë mjedisore. Për të realizuar këtë, zhvillimi i

kapaciteteve të mëdha të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE) është një hap thelbësor, duke u bazuar në potencialin teknik dhe ekonomik të këtyre burimeve.

Shumica e aktiviteteve të parapara për këtë periudhë janë të orientuara në krijimin e një baze ligjore dhe infrastrukturore që mundëson zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme.

Në vitin 2024, janë përfunduar aktivitetet në vijim:

- Miratimi i Ligjit për Burime të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE);
- Studimi i fizibilitetit për zhvillimin e projektit për Ngrohje Qendrore (NQ) diellore-Solar4Kosovo;
- Studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social, për sistemin e Ngrohjes Qendrore (NQ) në nëntë (9) komunat e Republikës së Kosovës;
- Organizimi i ankandit të parë në Republikën e Kosovës për 100MW të energjisë solare.

**Objektivi 3: Rritja e Efiçiencës së Energjisë (EE)**

Përmirësimi i Efiçiencës së Energjisë (EE) është një komponent kyç në përpjekjet për të arritur qëllimet e strategjisë energjetike. Rritja e Efiçiencës së Energjisë (EE) ndihmon në sigurinë e furnizimit me energji, duke ulur varësinë nga importet dhe duke e bërë sistemin energjetik më të qëndrueshëm. Po ashtu, ulja e kërkesës për energji çon në reduktimin e kostove për konsumatorët dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së ajrit, duke ulur ndotjen dhe emetimet e Gazrave Serrë (GS).

Në vitin 2024, numri i aktiviteteve që kanë pasur zhvillim, dhe që kanë kontribuar në rritjen e Efiçiencës së Energjisë (EE), përfshin një sërë aktivitetesh dhe projekte të cilat ndikojnë në përmirësimin e përdorimit dhe kursimit të energjisë.

Këto aktivitete janë:

- Miratimi dhe aprovimi i Ligjit për Performancën Energjetike të Ndërtesave;
- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të Ngrohjes Qendrore (NQ) në Prishtinë;
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në ndërtesa publike në nivel qendror dhe në nivel komunal nëpërmjet të cilave arritur kursim i energjisë  në vlerë 6.6 ktoe /vit;
- Instalimi i pajisjeve matëse për konsumatorët e “Termokosit”;
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në sektorin rezidencial (shtëpi individuale);
- Studimi i fizibilitetit për rritjen e kapacitetit termik në kogjenerimin TC “Kosova B” nga 140 MWth në 280MWth;
- Fushata për ndërgjegjësimin e publikut.

**Objektivi 4: Forcimi i Bashkëpunimit Rajonal dhe Funksionimit të Tregut**

Në vitin 2024, aktivitetet që kanë pasur zhvillim dhe që kanë kontribuar në forcimin e bashkëpunimit rajonal, dhe në funksionimin e tregut energjetik në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë (TKE) kanë përfshirë një sërë aktivitetesh të cilat synojnë integrimin e

tregut energjetik të Kosovës në atë rajonal dhe më gjerë, si dhe rritjen e konkurrencës dhe transparencës. Aktivitetet kryesore në këtë periudhë përfshijnë:

- Bashkimi me tregun një (1) ditë para me Shqipërinë përmes bursës së energjisë Alpex;
- Bashkimi me tregun një brenda ditës me Shqipërinë përmes bursës së energjisë Alpex;
- Hartimi i draftligjit për energjinë elektrike;
- Hartimi i draftligjit për energjinë;
- Hartimi i draftligjit për Zyren e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE);
- Hartimi dhe miratimi i standardeve dhe kurrikulave të reja profesionale sipas kërkesave të tregut të punës.

**Objektivi 5: Mbrojtja dhe Fuqizimi i Konsumatorëve**

Strategjia e energjisë vendos njerëzit në qendër të saj dhe vendos objektivat në këto fusha, andaj për këtë qëllim janë paraparë disa aktivitetet në Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025.

Në vitin 2024 janë paraparë disa aktivitete për mbështetjen e konsumatorëve në nevojë të cilat janë integruar në një aktivitet dhe ngritjen e kapaciteteve për stafin e AMMK-së për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e emetimeve nga impiantet e mëdha.

- Hartimin dhe miratimin e programit një (1) vjeçar për zbatimin e masave për mbështetjen e konsumatorëve në nevojë;
- Rritja e kapaciteteve të AMMK-së për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e emetimeve nga impiantet e mëdha me djegie;
- Janë realizuar fushata vetëdijësuese dhe informuese për sektorin e energjisë nga ME-ja, dhe nga institucionet tjera: Termokos, NQ-e Gjakova, KEDS, FKEE, ku total numri i fushatave të realizuara është shtatëmbëdhjetë (17).

# 5 RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Gjatë monitorimit të zbatimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025, janë hasur rreziqet të cilat lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, vonesa në procedura të prokurimit, si dhe faktorë të tjerë të jashtëm që janë shfaqur gjatë realizimit të aktiviteteve, dhe që ndikojnë në zbatimin e dokumentit strategjik.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025, Ministria e Ekonomisë (ME), përkatësisht Departamenti i Energjisë (DE), ka koordinuar procesin e hartimit të raportit të progresit aktiviteteve të parapara. Ky monitorim është bërë duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse ku janë identifikuar rreziqet të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme me masa konkrete. Ministria e Ekonomisë (ME), do të vazhdoj bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet relevante dhe ndërmarrjet

kryesore të sektorit të energjisë në adresimin e të gjitha rreziqeve me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen.

Planifikimi i duhur i projekteve dhe aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse, është mjaft i rëndësishëm në suksesin dhe zhvillimin e sektorit të energjisë, prandaj rol të rëndësishëm luan edhe lehtësimi i procedurave burokratike me qëllim të mosvonesës dhe ngecjes së realizimit të projekteve.

**Sfidat dhe mangësitë:**

Sfidat, mangësitë dhe pengesat e hasura gjatë monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të PZSEK-së:

-mungesa e kapaciteteve humane dhe profesionale në kuadër të institucioneve për të trajtuar projekte komplekse energjetike është një problem kyç. Kjo përfshin mungesën e ekspertëve të kualifikuar në fushat teknike, menaxheriale dhe të monitorimit;

-kapaciteteve financiare, varshmëria e realizimit të projekteve nga donatorët, sidomos situata e krijuar pas vendosjes së njëanshme nga BE-ja të masave, sidomos të atyre me karakter financiare mosnënshkrimi i marrëveshjeve për financim të projekteve dhe ratifikimi i tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës;

-mjedis jo i përshtatshëm rregullator, vonesa në marrjen e lejeve nga institucionet përkatëse për ndërtim, shpronësimi i tokave dhe ngritja e çmimeve në treg, çmimet e vjetra të kontratave, vonesa në procese të prokurimit;

-mungesë e koordinimit të mjaftueshëm në mes të institucioneve, si dhe

-faktorët e tjerë të jashtëm (ndryshimet globale si krizat energjetike, çmimet e paqëndrueshme të energjisë dhe ndikimet e politikave ndërkombëtare edhe në raport me agjendën e gjelbërt) që ndikojnë në nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik.

**Konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm**

Fakti që është shënuar një progres i kënaqshëm dhe se në vitin 2024 është arritur realizimi i objektivave në masën prej pesëdhjetë e shtatë përqind (57%), tregon një përparim të rëndësishëm në implementimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022 - 2025. Kjo përqindje tregon se shumë aktivitete janë realizuar, por gjithashtu lë hapësirë për përmirësime dhe forcimin e përpjekjeve për të arritur objektivat e plota të planifikuara.

Disa nga pengesat dhe shkaqet e vonesave ose mosrealizimit të aktiviteteve janë: mosratifikimi i marrëveshjeve financiare, planifikimi jo i duhur i afateve kohore të implementimit të aktiviteteve, procedura burokratike për marrjen e lejeve të ndryshme për realizimin e aktiviteteve të parapara, vonesa në procedurat e prokurimit dhe mungesa e fuqisë punëtore të profilizuara.

**Rekomandimet**:

Duke u bazuar në sfidat dhe mangësitë e identifikuara nga raportimet e institucioneve mbi zbatimin e aktiviteteve dhe masave në kuadër të objektivave strategjike, rekomandimet dhe hapat e ardhshëm për përmirësim përfshijnë:

- Përmirësimin e planifikimit të afateve kohore për miratimin e kornizës ligjore;
- Rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Lehtësimin e procedurave për marrjen e lejeve, duke shmangur vonesat në fillimin e projekteve;
- Shpronësimin e pronave në kohë, në zonat ku do të realizohen projektet;
- Planifikim më të saktë të aktiviteteve dhe afateve kohore të zbatimit të projekteve, duke marrë parasysh sfidat e mundshme;
- Nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjeve financiare në kohë nga institucionet përgjegjëse.

# 6 SHTOJCA- MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2024

***MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË PZSEK-së PËR PERIUDHËN 2022-2025: OBJEKTIVI STRATEGJIK 1***

### SO1: PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË SË SISTEMIT

| Nr. | Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet. | Vlera bazë | Objektivi afatshkurtër 2025 | Objektivi i vitit të fundit 2031 | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| **I.** | **OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË SË SISTEMIT** | | | | |
| 1 | Indikatori: Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit (SAIDI). | SAIDI: 80.83 orë/vit (2021) | SAIDI: 63 orë/vit | SAIDI: 51.84 orë/vit | |
| 2 | Indikatori: Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve të sistemit (SAIFI). | SAIFI: 58.27 (2021) | SAIFI: 49 | SAIFI: 40.86 | |
| **I.1** | **Objektivi specifik: Rritja e fleksibilitetit të sistemit** | | | | |
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | **Objektivi afatshkurtër 2025** | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | |
| 1 | Niveli i kapacitetit rregullues fleksibil. | 5 MW (2022) | 5 MW | 170 MW | |

| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti | | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti | Referenca në dokumente | Progresi në zbatim për vitin 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Viti** 2022 | **Viti 2023** | **Viti 2024** | **Viti** 2025 | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.1 | Përgatitja e parafizibilitetit, fizibilitetit dhe projekteve teknike për sistemin e ruajtjes së baterive. | 2025 | € - | $ 1,180,837.00 | **$ 3,078,637.00** | $ 242,079.00 | Donatorë | MCC, ME KOSTT | Dokumentacioni teknik i përgatitur. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | Konsulenti per Dizajn dhe Mbikqyrje për sistemin e ruajtjes së energjisë me bateri (BESS) është kontraktuar, dhe ka filluar punën në nëntor të vitit 2023. Është hartuar dizajni bazë fillestar për nënstacionin dhe sistemin e ruajtes së energjisë me bateri për ta mundësuar kycjen në rrjetin e transmisionit, si dhe përgaditjen e pakos tenderuese për ndërtimin e BESS. Konsulenti ka përfunudar analizat gjeoteknike të lokacionit ku do të ndërtohet sistemi i baterive për nevoja te KOSTT-it, dhe ESCorp. Gjithashtu është lansuar procesi i parakualifikimit për ndërtimin e sistemeve të ruajtjes së energjisë. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.2 | Mbështetje teknike dhe ligjiore për integrimin e baterive - Projekti i MCC. | 2025 | € - | $ 1,916,000.00 | **$ 2,034,667.00** | $ 2,045,667.00 | Donatorët | MCC, ME KOSTT | Dokumentacioni teknik i përgatitur. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | Konsulentet Mbështetës për sistemin e ruajtjes së energjisë me bateri (BESS) janë kontraktuar në maj të vitit 2023 të cilët janë angazhuar në hartimin dhe plotësimin e kornizës ligjore për të mundësuar kyçjen e baterive në rrjet, si dhe analizen e opsioneve për pronësinë e batërive për KOSTT. Këta dy (2) konsulentë kanë dhënë mbështetje të përgjithshme për përgatitjen e dokumentacionit për krijimin e ndërmarrjes së re publike Korporata e Ruajtjes së Energjisë ShA me vendim të Qeverisë së Republikḩs së Kosovës (QRK), si dhe mbështetje për plotësimin e kushteve pararendëse, duke përfshirë mbështetjën ligjore për sgiruimin e paluajtshmërive për ndërtimin e projekteve. Kjo mbështetje ka vazhduar përgjatë vitit 2024. Sa i përket funksionalizimit të ndërmarrjes së re publike, pas krijimit të ndërmarrjes me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) më 13 mars 2024, janë lansuar konsulencat për rekrutim të stafit të ndërmarrjes, si dhe për asistencë teknike, e cila do të mbështesë ndërmarrjen në hartimin e Planit të Biznesit (PB), rregulloreve teknike për operim të baterive, politikave të qeverisjës korporative dhe financiare, etj. Gjithashtu është shpallur konkursi për Drejtor të Bordit (DB) në |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | Korporatën e Ruajtjes së Energjisë. |
| I.1.3 | Master Plani i Zhvillimit të Gazit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (VNM). | 2023 | € 750,000.00 | € 750,000.00 | € - | € - | WBIF / IPF9 | ME, MMPHI, MINT | Masterplani i Gazit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor i Finalizuar. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | Ky studim është finalizuar në vitin 2023 dhe është raportuar si i tillë. |
| I.1.4 | Studimi i fizibilitetit për Gazsjellësin e Interkoneksionit të Maqedonisë Veriore – Kosovë. | 2023 | € 325,000.00 | € 325,000.00 | € - | € - | WBIF/IPF9 | ME, MMPHI, MINT | Studimi i fizibilitetit i finalizuar. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | Ky studim është finalizuar në vitin 2023 dhe është raportuar si i tillë. |
| I.1.5 | Studim për identifikimin e potencialit të energjisë gjeotermale në Kosovë. | 2025 | | | | € 750,000.00 | Donatorët | ME | Studimi i fizibilitetit i realizuar. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | |

| I.2 | Objektivi specifik: Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | **Objektivi afatshkurtër 2025** | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | |
| 1 | Humbjet në shpërndarje | 18.48% [2021] | 13.3 % | 9% | 14.49% (2024) |
| 2 | Sasia e kapacitetit variabil të BRE-ve, që rrjeti është në gjendje të tajtojë/integrojë. | 147 MW [2021] | 500 MW | 2000 MW | 1400 MW (2024) |

| **Nr.** | **Veprimi** | **Afati i fundit** | **Buxheti** Viti 2022 | Viti **2023** | Viti **2024** | Viti 2025 | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim për vitin 2024** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.2.1 | Zhvillimi i sistemit (SCADA & Telekomunikacion). | Vjetore | € - | € 5,684,923.33 | **€ 4,063,814.93** | € 1,863,702.50 | KOSTT | KOSTT | Kërkesat e ENTSO-E janë plotësuar. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | Këto projekte i takojnë grupit të projekteve që do të realizohen me bankën Gjermane KfW faza e VII. Eshtë nënshkruar kontrata për shërbime konsulente me 26.11.2024 për përgaditjen e specifikimit teknik dhe tender dosjen. Projektet pritet të realizohen gjatë TM1 2026- TM4 2027. |
| I.2.2 | Përforcimi dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues të energjisë (OST). | Vjetore | € 2,400,000.00 | € 2,260,000.00 | **€ 1,063,542.37** | € 1,354,203.39 | KOSTT | KOSTT | Rritja e besueshmërisë dhe sigurisë së rrjetit | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | |
| I.2.3 | Ndërtimi i kapaciteteve të reja të transmetimit dhe kapaciteteve transformuese - Reaktori shunt-variabël (100 MWAr). | 2025 | € - | € 1,000,000.00 | **€ -** | € 3,449,152.54 | KOSTT | KOSTT | Rritja e besueshmërisë dhe sigurisë së rrjetit. Plotësimi i kërkesave të Kodit të Rrjetit. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | |
| I.2.4 | Mbështetja e ngarkesës/ Nyjet e reja 110/10 (20) kV (OST & OSSH) (SS Katrioti - Ferizaj 3 dhe TS Malisheva (SS Katrioti - Ferizaj 3 and TS Malisheva. | Vjetore | € 3,000,000.00 | € 5,061,277.00 | **€ 10,094,931.52** | € - | KOSTT | KOSTT | Reduktimi i humbjeve të energjisë dhe fuqisë së pashërbyer. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | 1. Projekti " Ndërtimi i NS 110/35/10(20) kV Ferizaji3" ka përfunduar.<br>2. Projekti " Ndërtimi i NS 110/35/10(20) kV Fushë – Kosova" me linjën përcjellëse ka përfunduar dhe me instalimin e trafos |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | 40MVA nënstacioni është energjizuar më datën 15.12.2024.<br>3.Sipas ligjeve në fuqi është përgaditur Dizajni për nënstacionin e NS Malisheva, nga kompania dizajnuese, janë marrë kushtet ndërtimore, pritet edhe leja e ndërtimit nga MMPHI . Është përgaditur specifikimi teknik dhe pritet tenderimi gjatë TM1-2025. Periudha e implementimit TM3 2025 - TM4 2026. |
| I.2.5 | Projektet e Tensionit të Mesëm 35/10(20) kV | Vjetore | € 9,247,735.33 | € 13,216,444.00 | **€ 8,800,613.00** | € 7,232,203.00 | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | 7,330,808.67 ( Euro ).<br>Në vitin 2024 projektet investive të tensionit të mesëm të implementuara në vitin 2024 u drejtuan në rajonet si: Lipjan, Gjakovë, Malishevë, Skenderaj, Vushtrri, Klinë, Pejë, Deçan, Obiliq, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Dragash, Ferizaj, Fushë - Kosovë, Kaçanik, Kamenicë, Prizren, Rahovec dhe Viti.Rrjeti i tensionit të mesëm është përforcuar në përputhje me planet e ardhshme të daljeve. Në investimet në TM dhe në TU janë ndryshuar të gjitha linjat, nënstacionet dhe pajisjet e tjera që nuk plotësonin kriteret teknike. Këto projekte kanë për qëllim përmirësimin e nivelit të tensionit dhe të furnizimit cilësor me energji elektrike. | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.2.6 | Projektet e Tensionit të Vogël 0.4 kV | Vjetore | € 6,086,381.41 | € 7,025,149.00 | **€ 13,795,229.00** | € 9,677,563.00 | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | 8,699,661.75 Euro.<br>Në vitin 2024 projektet investive të tensionit të ulët të implementuara në vitin 2024 u drejtuan në rajonet si: Lipjan, Gjakovë, Malishevë, Skenderaj, Vushtrri, Mitrovicë, Klinë, Pejë, Deçan, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Dragash, Ferizaj, Fushë - Kosovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Prizren, Rahovec, Shtime dhe Viti.Investimet në rrjetin e tensionit të ulët ndahen në projekte të llojit përforcim i rrjetit dhe zgjerim i rrjetit. Projektet e llojit ldhjet e reja të cilat implementohen nga OSSh-ja, gjithashtu hyjnë në kategorinë e zgjerimit të rrjetit.<br>Në gjithë rrjetin e OSSh-së, ka pjesë të cilat kërkojnë investime për shkak të gjendjes së vjetruar. Në mënyrë që të investohet në zonat më kritike, analiza është bërë duke marrë parasysh kriteret e prioriteteve për zgjedhjen e projekteve. |
| "I.2.7 | Rrjeti i zgjuar (Smart Grid). | Vjetore | € 14,513.93 | € 2,413,843.29 | **€ 3,444,527.64** | € 1,765,071.00 | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të | 3,841,450.46 Euro.<br>Në vitin 2024 ka pasur shumë investime në rrjetin e shpërndarjes, duke rritur efikasitetin dhe besueshmërinë e tij. Investimet kryesore përfshijnë vendosjen e pajisjeve të mençura, instalimin e sistemit SCADA në stabilimente, ndërrimin e transformatorëve të fuqisë dhe releve në nënstacione dhe fillimin e projektit GIS. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | Ne kemi krijuar gjithashtu një qendër të dytë kontrolli SCADA dhe kemi instaluar reaktorin e parë në rrjet. Të gjitha këto investime kanë përmirësuar monitorimin, identifikimin e defekteve dhe performancën e përgjithshme të rrjetit, duke siguruar cilësi më të mirë të energjisë dhe ulje të kohës së ndërprerjes për konsumatorët. |
| I.2.8 | Instalimi i njehësorëve. | Vjetore | € 1,612,032.60 | € 4,000,015.00 | **€ 2,494,035.00** | € 2,111,940.00 | KEDS | KEDS | Reduktimi i humbjeve komerciale për periudhën 2022-2025 parashikohet të instalohen rreth 121,782 njehsorë të rinjë - lidhjet e reja, ndërsa parashikohet të ndërrohen rreth 86,578 njehsorë. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | 10,446,297 Euro.<br>- Gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2024 OSSh-ja, ka realizuar rreth 27,238 ndërrime të njehsorëve ku prej tyre rreth 4,681 janë ndërrime nga njehsorët mekanik në njehsorë digjital.Arsyjet e ndërrimit të njehësorëve janë:<br>-Modernizimi i matjës nga njehsorë eletronikë në njehsorë Smart;<br>-Vendosja e njehsorëve PLC sipas projekteve të TU të aprovuara nga ZRrE-ja;<br>- Ndërrimet e njehsorëve nga mekanik në elektronik;<br>- Vlefshmërisë së vulës Metrologjike (sipas Metrologjisë Ligjore);<br>- Njehsorët për Prosumatorë (panele solare). |
| I.2.9 | Investimet kapitale në Teknologjinë Informative (TI). | Vjetore | € 896,096.30 | € 1,544,650.00 | **€ 2,147,700.00** | € 1,331,800.00 | KEDS | KEDS | Funksionimi i sigurtë i OSSh-së. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatori | 1,561,588.43 Euro.<br>-Projektet e Teknologjisë Informative (TI) janë investime me rëndësi të lartë për OSSh-në, gjatë vitit 2024, janë bërë përparime të rëndësishme në zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve Teknologjisë Informative (TI). Janë realizuar investime për rritjen e |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | t të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | sigurisë, modernizimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e funksionimit të proceseve teknologjike, duke rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit. |
| **I.3** | **Objektivi specifik: Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike** | | | | | | | | | | |
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | | | **Objektivi afatshkurtër 2025** | | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | | | | |
| 1 | Numri i njësive të rinovuara të linjitit. | 0 [2021] | | | 2 | | 3 ose 4 | | | | |
| 2 | Numri i njësive të mbyllura të linjitit. | 0 [2021] | | | 0 | | 1 ose 2 | | | | |
| **Nr.** | **Veprimi** | **Afati i fundit** | **Buxheti** | | | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim për vitin 2024** |
| | | | **Viti** 2022 | **Viti 2023** | **Viti 2024** | **Viti** 2025 | | | | | |
| I.3.1 | Rehabilitimi i njësisë “Kosova B1” | 2024 | € - | € 7,500,000.00 | **€ 88,000,000.00** | € - | KEK: € 49.5 milion Granti nga BE: € 38.5 milion (Elektrofiltrat & De-Nox). | KEK, ME, ZRrE | Reduktimi i emetimit të pluhurit, NOx dhe $SO_2$ Pluhuri: 20 mg/ $Nm^3$, NOx: 200 mg/ $Nm^3$, $SO_2$: 600 mg/ Nm | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Strategjia Zhvillimore e KEK-ut për periudhën 2021-2025 | Projekti i DeNOx-it dhe i Filtrave Elektrostatik (elektrofiltrat) është Zhvendosur për vitet 2026 per njësinë B1 dhe 2027 për njësinë B2. Për shkak të këtij spostimi janë spostuar gjithashtu edhe projektet të cilat KEK/TCB i ka planifikuar që ti implementoi në ketë periudhë kohore të DeNOx-it dhe filtrave elektrostatik. Gjatë vitit 2025 do të realizohen projektet, modrnizimi i turbinës, ndërrimi i zbarrave të gjeneratorit, në njësinë B2 të kontraktuara nga KEK-u. Kjo do të thotë se nuk ka ndonjë progres në implementim të projekteve |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | në periudhën janar – dhjetor 2024. |
| I.3.2 | Rehabilitimi i njësisë “Kosova B2” | 2025 | € - | € 7,500,000.00 | € - | € 88,000,000.00 | KEK - €49.5 milion EU Grant - € 38.5 milion (Electrofilter & De-Nox) | KEK, ME, ZRrE | | | Projekti i DeNOx-it dhe i Filtrave Elektrostatik (elektrofiltrat) është Zhvendosur për vitet 2026 për njësinë B1 dhe 2027 për njësinë B2. Për shkak të këtij spostimi janë spostuar gjithashtu edhe projektet të cilat KEK/TCB i ka planifikuar që ti implementoi në ketë periudhë kohore të DeNOx-it dhe filtrave elektrostatik. Gjatë vitit 2025 do të realizohen projektet, modrnizimi i turbinës, ndërrimi i zbarrave të gjeneratorit, në njësinë B2 të kontraktuara nga KEK-u. Kjo do të thotë se nuk ka ndonjë progres në implementim të projekteve në periudhën janar – dhjetor 2024. |
| I.3.3 | Rehabilitimi i një njësie të “Kosova A” | 2024 | - | € 15,000,000.00 | **€ 105,000,000.00** | € - | KEK | KEK, ME, ZRrE | Rritja e kapacitetit nga 130 MW në 180 MW. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | Specifikimi teknik është përfunduar dhe është dorzuar pran Menaxhmentit të Lartë dhe Bordit. Në dhjetor të vitit 2024 është miratuar buxheti inicues për projektin e rehabilitimit dhe modernizimit të njësisë A3. Inicimi i procesit nga Zyra e Prokurimit (ZP) është bërë më datë 23.01.2025. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.3.4 | Makineri, shirita transportues, shpronësime dhe investime të tjera në shpronësimin e minierave. | 2024 | € 3,800,000.00 | € 48,200,000.00 | **€ 28,340,000.00** | € 28,340,000.00 | KEK | KEK, ME, ZRrE | Investimet në minierë | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | Nga njësitë inicuese të gjitha kërkesat që kanë arritur në DIP, janë proceduar për trajtim të metutjeshëm në DF dhe ZEP. |
| **I.4** | **Objektivi specifik: Garantimi i sigurisë kibernetike të sektorit të energjisë** | | | | | | | | | | |
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | | | **Objektivi afatshkurtër 2025** | | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | | | | |
| 1 | Aftësitë e reagimit kibernetik. | Nuk ekziston | | | Ekzistojnë | | Ekzistojnë | | | | |
| **Nr.** | **Veprimi** | **Afati i fundit** | **Buxheti** | | | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim për vitin 2024** |
